



Planuar / Doretuar Primjena / Produoto Received / Delivroy	05 - 07 2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTCK	3919/2022		114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.14/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.681/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.14/2020 të datës 21.01.2020 të parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_ me adresë banimi \_\_\_\_\_

në Prishtinë, kundër organit të punësimit Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në çështjen juridike "kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 05.07.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.14/2020 e datës 21.01.2020 e parashtruar nga ankuesja \_\_\_\_\_

A r s y e t i m

Ankuesja \_\_\_\_\_ e cila sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në Departamentin e Inspektimit të Arsimit në MASHT-it, me vendimin e datës 23.01.2015 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë është caktuar pjesë e grupit punues për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës, ku edhe do të paguhet për angazhimin në këtë grup.

Ankuesja për shkak të mos pagesës për angazhimin në grupin punues për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës ka bërë disa kërkesa



disa herë për kompensim të pagesës për kontributin e dhënë ndërsa kërkesën e fundit të bërë në adresë të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Arsimor të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka bërë me datë 05.12.2019.

Ankuesja e pakënaqur me mungesën e përgjigjes nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Arsimor të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është pranuar më datë 21.01.2020 dhe është protokolluar me numër protokolli 173/2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datën 27.01.2020 në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e ka proceduar kërkesën për përgjigje ankesën e ankueses, ndërsa me datë 05.02.2020 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 26.02.2020, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, ka ndjekur procedurat e tjera administrative duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 27.05.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.681/20 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 26.02.2020 duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e ankueses të datës 25.01.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër protokolli 173/2020 e datës 21.1.2020 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 05.12.2019; Kërkesa e datës 11.10.2019, kërkesa e datës 06.07.2015; Vendimi numër 155/dtb i datës 01.08.2017; vendimi numër 2-149 i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë i datës 23.01.2015; vendimi numër 162/01B i datës 21.08.2017; E-maili i datës 02.12.2019 me e-maillet e bashkëngjitura; Vendimi nr:2/888 i datës 01.04.2015; vendimi i datës 25.05.2016; kërkesën e datës 30.11.2016; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 27.01.2020; Përgjigja në ankesë e datës 05.02.2020; Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 05.12.2019; Akt emërimi i ankueses i datës 02.04.2012; Përshkrimi im detyrave të punës për ankuesen; kërkesa e datës 06.06.2016; kërkesa e datës 27.10.2016; kërkesa e datës 22.12.2016; kërkesa e datës 24.11.2016; Kopja e pyetësorëve për planin dymujor për vitin 2017/2018; Raporti për Kurrikulën me Zgjedhje për muajin tetor 2017; Raporti për Kurrikulën me Zgjedhje për muajin maj 2015; Raportin i orëve të punës jashtë orarit për muajit prej janari deri në dhjetor të vitit 2015; Raportin i orëve të punës jashtë orarit për muajt maj, qershor, korrik, gusht, dhjetor të vitit 2017; lista e pagave për muajin mars dhe maj të vitit 2015; lista e pagave për muajt qershor, shtator, tetor, nëntor, dhjetor të vitit



2017, Njoftimin e datës 26.02.2022; Aktgjykim A.nr.681/20 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i datës 27.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankueses **është e palejuar, sepse:**

Kolegji i Këshillit në bazë të provave të lëndës, ka konstatuar se ankuesja sipas të Akt emërimit të datës 02.04.2012 mban pozitën "Inspektore e Arsimit" Departamenti i Inspektimit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ndërsa lidhur me angazhimin në grupin punues për zhvillimin dhe zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së Arsimit Parauniversitar të Republikës së Kosovës kërkesën e fundit për kompensim e ka parashtruar më datë 05.12.2020 tek Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit, ndërsa në mungesë të përgjigjes nga ana e Drejtori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Arsimit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës të cilat kanë qenë të aplikuara në kohën kur ankuesja e ka parashtruar ankesën në Këshill, respektivisht neni 50 paragrafi 2 i tij ka përcaktuar se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë mbrojtjeje përmes procedurave të brendshme administrative ose gjyqësore në rast të shkeljes së të drejtave të tyre, që rezulton nga një veprim i administratës publike"*, ndërsa në bazë të shkresave të lëndës nuk ka asnjë dëshmi që ankuesja kundër mungesës së përgjigjes nga ana e Drejtorit lidhur me kërkesën për kompensim në mënyrë retroaktive të ketë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë siç parashihet edhe në nenin 81 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës : *"Organe të veçanta për zgjidhjen e kontesteve të punësimit dhe të ankesave në shërbimin civil do të themelohen në kuadër të secilit institucion të administratës qendrore dhe komunale, që ka nëpunës civilë. 2. Procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave zhvillohen nga këto organe: 2.1. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; dhe 2.2. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës"* dhe po ashtu parashihet edhe me nenin 82 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj: *"Komisionet për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave themelohen në kuadër të çdo institucioni të administratës qendrore dhe komunale, si organe për zgjidhjen e kontesteve dhe pranimin e ankesave. 2. Vendimet e komisioneve për zgjidhjen e kontesteve dhe të ankesave janë të detyrueshme për institucionet e administratës publike dhe për të gjitha palët përkatëse. Kundër vendimeve të tyre mund të paraqitet ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës"*.

Andaj, në mbështetje të nenit 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, ku është përcaktuar se: *"Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës"*, nenit 16 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Nëpunësi civil, apo kandidati për pranim në shërbimin civil i cili është i pakënaqur me vendimin e organit të punësimit, ka të drejtë të parashtrtojë ankesë në Këshill..."* si dhe nenit 3 paragrafin 6 të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *"Para parashtrimit të ankesës në Këshill, ankuesi duhet t'i ketë shterur procedurat e brendshme të ankesave në organin e punësimit..."*, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar me datë 21.01.2020 në Këshilli është e palejuar, pasi që e njëjta nuk i ka



shterur procedurat e brendshme ankimore siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura ligjore të aplikuara në kohë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.14/2020

Flakron GASHI

  
Zyrtar i Lart për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, si dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

